



MINISTRIA E ARSIMIT,  
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

gtz Partner für Perspektiven.  
Weltweit.



# PORTFOLIO PËR ORIENTIM NË KARRIERË

Një pako testesh drejt zgjidhjes më të  
mirë për shkollimin/punën tuaj


Emri dhe mbiemri:

Institucioni/Vendi:

**Publikues:**

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë Kosovë dhe

Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit (GTZ) GmbH,



e ngarkuar nga Ministria Federale për Bashkëpunim  
Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), e Republikës Federale të  
Gjermanisë

**Konsulent:**

Dr. Erwin Kämmerer,

Shkolla e Lartë Pedagogjike në Steiermark (Austri)

**Grupi punues për hartimin e manualit:**

Sokol Elshani  
Milazim Avdylaj  
Arta Vitija

**Përkthyes:**

Ergys Prifti

**Shtypshkronja :**  
Promohome

**Numri i kopjeve:**  
1300 copë

Shtator 2010, Prishtinë

## Si të ndihmon portfolio yt për orientim në karrierë

Me siguri se do pyesësh veten, se përse ta kanë dhënë këtë dosje dhe si do të të ndihmoj ajo?

Kjo dosje ndryshe quhet edhe portfolio për orientim në karrierë dhe të ndihmon në përgatitjen tënde në vendimin e përzgjedhjes së shkollës për shkollimin tënd të mëtutjeshëm apo në përzgjedhjen e profesionit.

Më e rëndësishmja gjatë procesit të vendimmarrjes je ti. Rruga e vendimmarrjes ka dy qëllime kryesore:



### **Të njohësh veten nga fillimi**

Çka ëndërron dhe çka në të vërtet mund të arrish, është një dallim i madh. Rruga në mes të qëllimit dhe cakut është e gjatë dhe me plot sfida, dhe kjo ka një rëndësi të veçantë edhe për ty personalisht. Në çdo moment që ti bën diçka me dëshirë, aty mund të zbulosh diçka të rëndësishme për jetën tënde në të ardhmen.

Jo gjithmonë përputhen mundësitë me dëshirat, kështu që përmes kësaj rruge do ta njohësh veten dhe të përfundosh se ky/kjo jam unë.

### **Të zbulosh botën profesionale**

Ky është qëllimi i dytë i rëndësishëm. Këtu duhet të zbulosh cilat profesione do të ishin të përshtatshme për ju, në mënyrë që të keni një karrierë të suksesshme.

Me portfolio nënkuptojmë një dosje në të cilën i mbledh të gjitha fletët e punës të cilat i ke punuar në shkollë, apo edhe jashtë shkolle (p.sh. në familje) dhe të cilat kanë një rëndësi të veçantë në momentin e vendimmarrjes tënde, për llojin e shkollës që do të vazhdosh.

Konfrontohu me tema të rëndësishme të orientimit në karrierë duke u bazuar në interesat e tua, talentet dhe dëshirat e tua, vendos vet se cilat materiale do i vendosësh në portfolio dhe argumento përzgjedhjen.

Shembull: përshkrimi im personal, ku jam i fortë, aftësitë dhe talentet e mia, hobi, kërkesat shkollore /profesionale, kostoja e shkollimit, tregu i punës, përpunimi i informacioneve, Mind-Map lidhur me profesionin tim të dëshiruar, shënime nga intervistat me ekspertë, marrja e informacioneve mbi ndërmarrjet dhe profesionet e dëshiruara, vizita në panaire shkollore dhe

informative dhe një raport i shkurtër lidhur me këto vizita, raporte të shkurtra nga praktika lidhur me detyra interesante, aftësia për punë në ekip, sjellja etj.

Portfolio do të qartësoj se orientimi në karrierë është një proces dhe ndihmon në parapërgatitjen tënde për vendimmarrje, të mos lejosh që të tjerët të marrin këtë vendim aq të rëndësishëm për të ardhmen tënde.

Do të shohësh se ia vlen të mendosh disa herë lidhur me përzgjedhjen e shkollës apo profesionit dhe nëse është e nevojshme edhe të ndërrosh mendimin gjatë këtij procesi.

Në portfolio mund të paraqitësh aftësitë e tua dhe ti krahasosh ato me kërkesat e shkollës së dëshiruar apo profesionin e dëshiruar.

Portfolion do ta mirëmbash ti gjatë gjithë procesit deri në vendimmarrje. Rezultatet e tua të punës do ti mbledhësh përgjatë një periudhe më të gjatë kohore. Pra, aty do jenë të gjitha punët nga fillimi deri në fund të procesit të vendimmarrjes.

Mbetët përgjegjësi e jotja përzgjedhja dhe cilësia e materialeve që i vendos në portfolio.

Mbi rezultatet e tua do duhej të mendoje dhe të reflektuje:



## Pesë hapat deri tek vendimmarrja

Portfolio të ndihmon të gjesh qasjen në shkollën, gjegjësisht profesionin tënd hap pas hapi.

Kjo faqe të përshkruan ndërtimin e portfolios tënd, të jep një hyrje për renditjen e rezultateve tua (fletëve të punës) dhe disa këshilla për tema të mundshme.

### 1. Ta njoh veten



#### Hapi i 1.

Njoh më mirë veten – profili im personal

Në këtë pjesë mbledh fletë pune, të cilat i shërbejnë vetëvlerësimit tim

Me duhen gjetur përgjigjet me te sakta mbi pyetjet për hapin e 1 dhe atë;

Çka më intereson mua?

Cilat janë anët e mia të forta, aftësitë dhe talentet e mia?

Kush jam unë?

Interesimet e mia shkollore, interesimet e mia në kohën e lirë.

Si më vlerësojnë të tjerët?

### 2. Informohem, kërkoj dhe përpunoj

#### Hapi 2.



Informohem, hulumtoj dhe përpunoj

Në këtë pjesë i mbledhë fletët e punës respektivisht hulumtimet lidhur me ofertat për shkolla dhe mundësi punësimi (biografi interesante të profesioneve) si dhe oferta të rëndësishme informative lidhur me botën e punës nga qendra për informim profesional, qendrave për punësim, revistave, broshurave dhe faqeve të tjera të internetit etj.

Pyetjet për hapin e 2:

- ✓ Si i siguroj, përzgjedh dhe përpunoj informacionet e rëndësishme për mua?
- ✓ Cilat oferta për informim ekzistojnë?
- ✓ Si mund të siguroj oferta për informim?
- ✓ Si të orientohe në këtë det informacionesh?
- ✓ Sipas cila kritereve i rendis, përzgjedh dhe përpunoj këto informacione?
  - ❖ Çfarë oferte informacionesh ekziston?
  - ❖ Si mund të arrij deri tek ky informim?
  - ❖ Si mund ta gjej veten në këtë shumëllojshmëri ofertash?
  - ❖ Sa kam mundësi dhe si i përpunoj këto informacione?

### 3. Unë njoh disa rrugë të shkollimit dhe karrierës, të cilat shpjen në realizimin e profesionit të dëshiruar

Do të merrem me ofertat e informacioneve, të cilat janë të rëndësishme për përzgjedhjen e shkollës, shkollimit dhe profesionit!

Do të krahasoj interesat e mia, pikat e mia të forta dhe talentet e mia me kërkesat e shkollave dhe profesioneve të preferuara dhe do ti diskutoj me prindërit e mi të priturat e mia shkollore dhe profesionale.

#### Hapi i 3.



Tani njoh rrugët e shkollimit të cilat më shpiejnë në realizimin e profesionit të dëshiruar.

Në këtë pjesë mbledhë fletë pune, në të cilat unë merrem në mënyrë intensive me zgjedhjen e shkollave dhe profesioneve dhe për të cilat e di se janë të rëndësishme për përzgjedhjen e rrugës së shkollimit dhe karrierës.

Të gjenden përgjigjet më të plota në pyetjet për hapin e 3:

- ✓ Cila shkollë i përmbushë kërkesat e mia?
- ✓ Në cilat lëndë në veçanti do duhet të jem i mirë?
- ✓ Profesioni im i dëshiruar a ka më shumë të bëj me punë dore, punë me makina, punë mendore apo ka më shumë kontakt me njerëzit?
- ✓ A përshtaten kërkesat shkollore me profilin tim personal?
- ✓ Cila rrugë e karrierës më ndihmon të realizoj profesionin tim të dëshiruar?

### 4. Njihem me shkollat dhe profesionet e preferuara (rrugët e shkollimit)

Hulumtimet e mia mbi shkollat dhe ndërmarrjet do ti përgatis mirë, do të krahasoj llojet e shkollave, do të shënoj gjendjen në treg të profesioneve të dëshiruara, si dhe të profesioneve të mundshme alternative.

Të analizohen mendimet, sugjerimet e prindërve, mësuesve dhe shokëve.



#### Hapi i 4.

Njihem me shkollat dhe profesionet e preferuara (rrugët e shkollimit)

Në këtë pjesë mbledhë rezultatet nga praktika profesionale siç janë: raporte, intervista me ekspertë, pyetësorë hulumtues: mbi shkollat respektivisht ndërmarrjet, qendra informative, panairë informative etj.

Pas njohjes me praktikën, a i përmbush kjo shkollë edhe më tutje kërkesat e mia, apo duhet të orientohem sërish diku tjetër?

Pyetjet për hapin e 4:

- ✓ Cilat janë interesimet që unë gjithsesi duhet ti kem?

- ✓ A është kërkesa për regjistrim në këtë shkollë e lartë apo e ulët?
- ✓ Cilat janë aftësitë që duhet pasur për praktikën profesionale?
- ✓ Cilat punë paraqiten gjithnjë?
- ✓ Sa zgjatë shkollimi?
- ✓ Çka shoh ndryshe pas përfundimit të shkollës dhe praktikës profesionale?

## 5. Verifikoj dhe vendos



### Hapi i 5.

Tani e njoh veten më mirë. Tani di më shumë lidhur me rrugët e shkollimit dhe kam mësuar të informohem. Kjo natyrisht se më sjellë më shumë siguri për vendimmarrje. Rezultatet e mbledhura do ti shfrytëzoj si ndihmesë për orientim në karrierë.

Në këtë pjesë krahasoj respektivisht verifikoj edhe njëherë profilin tim personal me kërkesat e rrugës së shkollimit dhe karrierës dhe vendos për shkollën përkatëse

Njihem me shkollat dhe profesionet e preferuara (rrugët e shkollimit). Hulumtimet e mia mbi shkollat dhe ndërmarrjet do ti përgatis mirë, do të krahasoj llojet e shkollave, do të shënoj gjendjen e profesioneve të dëshiruara në treg, si dhe të profesioneve të mundshme alternative. Të analizohen mendimet, sugjerimet e prindërve, mësuesve dhe shokëve.

Pyetjet për hapin e 5:

- ✓ Cilat janë shkollat që ke në përzgjedhjen e ngushtë?
- ✓ Për cilën ke vendosur?
- ✓ Përse ke vendosur të shkosh në këtë shkollë?
- ✓ A ishte vendim i lehtë?

#### 4 Vizitat dhe praktika.

Mbaj shënime dhe raporte mbi të gjitha vizitat e realizuara gjatë kohës së përgatitjes për vendimmarrje.

Shënime dhe raporte për punën praktike, raportet e punëdhënësit, ekspertit etj.

#### 5 Verifikoj dhe vendosi

Tani e njoh veten më mirë. Tani di më shumë lidhur me rrugët e shkollimit dhe kam mësuar të informohem. Kjo natyrisht se më sjellë më shumë siguri për vendimmarrje. Rezultatet e mbledhura do ti shfrytëzoj si ndihmesë për orientim në karrierë.

## Shtojcë



### Vetëvlerësimi im

### Interesimet e mia

### Pyetësi mbi interesimet e mia – vetëvlerësimi

Ky pyetësor me nëntë fusha interesesh më ndihmon të vlerësoj vet interesimet e mia dhe ti paraqes ato.

#### Udhëzim

Në secilën fjali në fushat e interesave mendohe m mirë, nëse ajo thënie më përshtatet mua, nëse puna e përshkruar më pëlqen apo ndoshta nuk më përshtatet.

Nëse një fjali e shënuar nuk të përshtatet meqë ajo punë nuk të intereson atëherë duhet nënvizuar me zero:

0 = nuk më përshtatet, nuk më intereson

Nëse një thënie të përshtatet vetëm pjesërisht, meqë veprimtaria të pëlqen vetëm pak atëherë duhet nënvizuar me një.

1 = përshtatet pjesërisht, më intereson vetëm pak

Nëse një thënie të përshtatet, meqë të pëlqen veprimtaria në këtë fushë, atëherë duhet nënvizuar me dy.

2 = përshtatet, më intereson

Nëse një thënie të përshtatet shumë, atëherë nënvizo me tre.

3 = përshtatet shumë, më intereson shumë



<b>Fusha e interesit 1 NATYRA</b>	Nuk përshtatet 0 Pikë	Përshtatet pak 1 Pikë	Përshtatet 2 Pikë	Përshtatet shumë 3 Pikë
Me dëshirë jam në natyrë dhe dalë sa herë të mundem				
Në shkollë e preferoj Biologjinë dhe lëndën për ambientin				
Dalloj shumë bimë në natyrë				
Më interesojnë vetitë e jetesës së shtazëve				
Me dëshirë do të ndihmoja në punët e kopshtit dhe të fushës				
Me dëshirë ndihmoj edhe në punë më të rënda				
Në Biologji interesohem edhe për çështje më specifike (p.sh. lakuriqët, etj.)				
Me dëshirë do ndihmoja në mbjelljen e bimëve dhe kujdesin e pemëve.				
Interesohem për kultivimin e bimëve				
Sille mirë me kafshët				
Gëzohem kur shoh kopshte të bukura.				
Ndjehem mirë kur mund të punoj në natyrë (në kopsht apo fushë).				
Kënaqem kur e lidhë një tufë lulësh				
Me dëshirë do ndërtoja një biotop në kopsht				
<b>Totali i pikëve</b>				



<b>Fusha e interesit 2 USHQIMI</b>	Nuk përshtatet 0 Pikë	Përshtatet pak 1 Pikë	Përshtatet 2 Pikë	Përshtatet shumë 3 Pikë
Më duket interesante puna në kuzhinë				
Më pëlqen të shërbej mysafirët				
Me dëshirë ndihmoj në përgatitjen e tavolinës dhe ushqimit				
Me dëshirë gatuaj në kohën e lirë				
Para se të filloj me gatim, i lë vetes mjaftueshëm kohë për parapërgatitje.				
Ushqimi dhe amvisëria janë lëndët e mia të preferuara.				
Me dëshirë blej gjëra ushqimore.				
Me dëshirë do të përgatisja një meny				
Me dëshirë do gatuaja bukë me lloje të ndryshme të miellit.				
Kënaqem kur e servoj ushqimin bukur				
Kam ndihmuar në dekorimin e sallatave.				
Më pëlqen të përgatis vetë marmelatën.				
Me dëshirë do bëja ëmbëlsira nga çokolata në forma të ndryshme				
Interesohem shumë për ushqim të shëndoshë.				
<b>Totali i pikëve</b>				

<b>Fusha e interesit 3 Disenjimi dhe puna e dorës</b>	Nuk përshtatet 0 Pikë	Përshtatet pak 1 Pikë	Përshtatet 2 Pikë	Përshtatet shumë 3 Pikë
Me shumë dëshirë vizatoj me dorë				
Vizatoj apo ngjyrosë edhe në kohë të lirë				
Kur mund të disenjoj/krijoj diçka, nuk mërzitem kurrë.				
Me dëshirë punoj sipas ideve dhe dezenëve të mia.				
Modeloj me dëshirë me baltë dhe materiale të tjera.				
Krijoj me dëshirë me materiale si letër, dru, tekstil, lëkurë, baltë etj.				
Kaloj shumë kohë në disenjim dhe krijim.				
Interesohem për mobile të mira, vazo, piktura etj.				
Në klasë jam pjesë e vizatuesve dhe krijuesve më të mirë.				
Më pëlqen shumë të disenjoj një shkrim të bukur.				
Nuk kalon asnjë javë pa disenjuara dhe krijuar.				
Me dëshirë do të disenjoja një format për mirënjohje, një letër etj.				
Do dëshiroja të krijoja një vepër artistike nga disa materiale të ndryshme.				
Me kënaqësi i ngjyrosë punimet e mia				
<b>Totali i pikëve</b>				

<b>Fusha e interesit 4 Ndërtimtaria, teknika shtëpiake, përpunimi i drurit</b>	Nuk përshtatet 0 Pikë	Përshtatet pak 1 Pikë	Përshtatet 2 Pikë	Përshtatet shumë 3 Pikë
Me kënaqësi punoj me vegla.				
Riparoj me dëshirë.				
Interesohem për ndërtime, shtëpi, rrugë, ura etj.				
Me dëshirë punoj me materiale si gurë, dru, metal etj.				
Shfrytëzimi i energjive natyrore, ngrohja solare dhe fuqia e erës është i rëndësishëm.				
Me dëshirë do të ndërtoja vet kolektorët solar.				
Kur bëhen riparime në shtëpi, unë me dëshirë ndihmoj.				
Jam i mirë në montimin e mobileve.				
Dua të ndërtoj një punëtori.				
E di si duhet riparuar një rubikon (çeshme) që pikon.				
Me kënaqësi do ndërtoja një binë/skenë nga druri.				
Me dëshirë bashkëpunoj kur ka diçka për të përforcuar, shpuar apo prerë.				
Me intereson se si funksionojnë dyert automatike.				
Që të kursej energji do ti izoloja vet, dyert, dritaret dhe muret.				
<b>Totali i pikëve</b>				

<b>Fusha e interesit 5 Industria teknike, zejtaria teknike</b>	Nuk përshtatet 0 Pikë	Përshtatet pak 1 Pikë	Përshtatet 2 Pikë	Përshtatet shumë 3 Pikë
Interesohem për teknikë				
Me dëshirë çmontoj pajisje të vjetra teknike dhe i montoj sërish.				
Me montimin dhe riparimin e pajisjeve teknike mund të merrem me orë të tëra.				
Më interesojnë makinat dhe aparatet (motorë).				
Renditja e veglave në kutinë e tyre është me rëndësi për mua				
Në shkollë më interesojnë tema si: mekanika, elektronika, kompjuteri.				
Me dëshirë do kryeja praktikën në një punëtori.				
Me kënaqësi punoj në dirigjues elektronik.				
Interesohem për të dhëna elektronike të automjeteve, avionëve etj.				
Përdorimi dhe programimi i lartëdirigjuesve dhe kompjuterëve më krijon kënaqësi				
Me kënaqësi punoj me metal dhe çelik				
Interesohem për prodhimin e rrymës.				
Puna teknike është hobi imi.				
E di se si funksionon ndërrimi i shpejtësive në biçikletë.				
<b>Totali i pikëve</b>				

<b>Fusha e interesit 6</b> <b>Planifikimi, llogaritja, vizatimi</b> <b>teknik, informatika, hulumtimi</b>	Nuk përshtatet 0 Pikë	Përshtatet pak 1 Pikë	Përshtatet 2 Pikë	Përshtatet shumë 3 Pikë
Shpesh i zgjidhë pyetjet e ndërlikuara				
Kryej me dëshirë punë që kërkojnë saktësi, matje, llogaritje, programim etj.				
Më interesojnë Fizika dhe Kimia				
Më pëlqen Matematika				
Më intereson hulumtimi i fuqive natyrore (p.sh. elektriciteti, energjia bërthamore, energjia solare etj.)				
Më intereson kompjuteri dhe programet kompjuterike				
Më intereson se si funksionojnë saktësisht diriguuesit elektronik.				
Lexoj me kënaqësi artikuj mbi burime natyrore të energjisë				
Vizatimet teknike dhe planet janë interesante.				
Më pëlqejnë eksperimentet teknike.				
Më interesojnë çështje nga Fizika, p.sh, çfarë është një atom?				
Më interesojnë zhvillimet aktuale të teknikë dhe shkencë natyrore.				
Interesohem për mundësitë më të reja të teknologjisë laserike.				
Unë di formula të rëndësishme fizike/kimike.				
<b>Totali i pikëve</b>				



<b>Fusha e interesit 7 Tregti, administratë, shitje, komunikacion, ekonomi, informatikë</b>	Nuk përshtatet 0 Pikë	Përshtatet pak 1 Pikë	Përshtatet 2 Pikë	Përshtatet shumë 3 Pikë
Më duket e rëndësishme të jesh i njoftuar me çështjen e parasë.				
Unë mësoj me dëshirë gjuhë të huaja.				
Do gëzohesha të punoja nganjëherë në kompjuter.				
Mua më interesojnë edhe vende tjera (gjeografia, ekonomia, mënyra e jetesës së njerëzve etj).				
Me kënaqësi punoj me kompjuter dhe numra.				
Unë interesohem për lajmet ekonomike.				
Gjatë blerjes krahasoj çmimet.				
Me kënaqësi mbledh gjëra që me kohë fitojnë në vlerë.				
Kur mendoj të bëj një punë më të madhe, atëherë planifikoj të gjitha hollësitë.				
Me dëshirë do kuptoja përse disa kompani janë të suksesshme, e disa të tjera duhet të mbyllen.				
E di saktë sa është kamata që marr unë në kursimet e mia.				
Me kënaqësi plotësoj formularë.				
Në treg me dëshirë do ndihmoja në shitje.				
Unë jam pjesë e çdo aksioni shitjeje të organizuar në shkollë.				
<b>Totali i pikëve</b>				

<b>Fusha e interesit 8</b> <b>Kontakti me njerëzit, arsimit, shëndetësia, këshillimi, kujdesi</b>	Nuk përshtatet 0 Pikë	Përshtatet pak 1 Pikë	Përshtatet 2 Pikë	Përshtatet shumë 3 Pikë
Kur mund të kujdesem për fëmijë, ata ndjehen mirë tek unë.				
Me kënaqësi punoj me njerëz, dhe shumë shpejt e gjej kontaktin me ta.				
Kur dikush më tregon për problemet e tij, unë kam durimin ta dëgjoj atë.				
Mund të kuptoj shumë lehtë atë që ndiejnë të tjerët.				
Jam gjithmonë i gatshëm të ndihmoj.				
Kur dikush ka nevojë për ndihmë, mua më tërheq ta ndihmoj.				
Me dëshirë u tregoj të tjerëve lojëra interesante.				
Kënaqem kur të tjerëve mund t'ju shpjegoj ose t'ju mësoj diçka.				
Është me rëndësi që njerëzve të tjerë tua lehtësojmë jetesën.				
Gjithmonë e di çfarë duhet bërë me fëmijët.				
Gëzohem kur më besojnë përgjegjësi për të tjerët.				
Di të sillm me njerëz të të gjitha moshave.				
Shumë shpesh mendoj lidhur me arsyet për të qenë i dëshiruar apo i padëshiruar.				
Dua të kem njohuri të mira lidhur me shëndetin dhe sëmundjet.				
<b>Totali i pikëve</b>				



<b>Fusha e interesit 9</b> <b>Gjuha, letërsia, lajmet, teatri,</b> <b>muzika, arti dhe shkencat</b> <b>humane</b>	Nuk përshtatet 0 Pikë	Përshtatet pak 1 Pikë	Përshtatet 2 Pikë	Përshtatet shumë 3 Pikë
Gjuha amtare është lënda më e preferuar e imja.				
Interesohem për Histori				
Me dëshirë shkoj në teatër dhe koncert.				
Më kënaqësi shkruaj ese				
Leximi është hobi im.				
Në klasë me dëshirë paraqes përmbledhjen e një libri.				
Me kënaqësi mendoj në mënyrë kritike lidhur me gjëra që kam parë, dëgjuar apo lexuar.				
Interesohem për tregime, gojëdhëna dhe përralla nga e gjithë bota.				
Me kënaqësi e luaj një rol teatral, për të cilin duhet mësuar përmendësh tekstin dhe të paraqitem.				
Me dëshirë do shkruaja një artikull për një gazetë.				
Ndjehem mirë kur jam i rrethuar me libra.				
Gjuhët e huaja janë lëndët më të preferuara.				
Me dëshirë e shkruaj atë që kam përjetuar.				
Nganjëherë mendoj për veten time dhe jetën.				
<b>Totali i pikëve</b>				



Unë krahasoj interesat e mia në gjysëmvetor

<b>Totali i pikëve</b>	<b>Fusha e interesit</b>
	1. Natyra
	2. Ushqimi
	3. Disenjimi dhe puna e dorës
	4. Ndërtimtaria, teknika shtëpiake, ndërtimi i brendshëm dhe i jashtëm, përpunimi i drurit
	5. Industria teknike, Zejtaria teknike
	6. Planifikimi, llogaritja, vizatimi teknik, informatika, hulumtimi
	7. Tregtia, administrata, shitja, komunikacioni, ekonomia, informatika
	8. Kontakti me njerëz, arsimit, shëndetësia, këshillimi, kujdestaria
	9. Gjuha, letërsia, lajmet, teatri, muzika dhe shkencat humane

## PËR ÇKA INTERESOHEM UNË



	Më intereson shumë	Më intereson pjesërisht	Nuk më intereson fare
Të jem me njerëz			
Të angazhohem me fëmijë			
T'ju ndihmoj të sëmurëve dhe të moshuarve			
Të angazhohem për të tjerët			
Të angazhohem për veten time			
Kujdesi ndaj kafshëve dhe sjellja me to			
Të jem në natyrë			
Të lëvizë			
Moda			
Të angazhohem fizikisht			
Teknika			
Muzika, të luaj një instrument			
Kimia			
Gjuhët			
Vendet e largëta			
Gatimi			
Të ndaj vetes kohën			
Organizimi			
Elektronika			
Vizatimi, disenjimi, krijimi			
Punë në kopsht, kujdesi për bimët			
Të merrem me mendimet e të tjerëve			
Drejtësia			
Gjithçka rreth shëndetësisë			
Të planifikoj, konstruktoj diçka			
Reklama			

Mendohem se cilat interesa do të mund të ishin një këshillues ose orientues për përzgjedhjen e shkollës gjegjësisht profesionit!

Unë po ashtu mendoj, se si mund ti realizoj në një formë interesat e mia përmes profesionit?







## PËRCAKTO TALENTET DHE AFTËSITË TUA!

Vlerëso veten në mënyrë kritike!

Unë  
vlerësoj


Ti më  
vlerëson

Aktiviteti	0	1	2		
<b>Shkathtësia:</b> Në punë dore dhe riparimin e gjërave jam...	i ngathtë	mesatarisht	i shkathtë		
<b>Ndërtimi i trupit, shëndetësia:</b> Gjatë sportit, shëtitjeve...	lodhem shumë shpejt	në të shumtën e rasteve i qëndrueshëm	i fortë, i qëndrueshëm		
<b>Koncentrimi:</b> Për gjërat që më interesojnë pak jam...	i hutuar, i pa-koncentruar	mjaft i koncentruar	shumë i koncentruar		
<b>Kujtesa (Fjalë, Numra):</b> Në tekste, fjalë dhe numra të mësuar kujtohem...	pak a shumë, jo edhe shumë gjatë	mesatarisht	shumë mirë		
<b>Kreativiteti:</b> Gjatë shkrimit të eseve, gjatë vizatimit dhe gjatë zgjidhjes së problemeve praktike kam...	pak ose nuk kam fare ide	nganjëherë kam ide të mira	në të shumtën e rasteve kam ide të mira		
<b>Aftësitë gjuhësore:</b> Në lëndët gjuhësore, tekstet, fjalët dhe definicionet i mësoj ...	me mjaft vështirësi	mirë	shumë shpejt dhe shumë mirë		
<b>Aftësitë matematikore:</b> I zgjidh të gjitha detyrat që kanë të bëjnë me numra, si llogaritje, gjeometri, fizikë...	me vështirësi dhe jo saktë	shpesh me lehtësi	shumë shpejt dhe shumë sigurt		
<b>Vizatimi dhe disenjimi:</b> Në vizatim me dorë të lirë dhe në disenjim jam...	më pak i talentuar	mesatarisht i talentuar	në të shumtën e rasteve shumë i talentuar		
<b>Gjeometri:</b> Në gjeometri unë vizatoj ...	shkel e shko	mesatarisht	shumë saktë dhe pastër		
<b>Aftësia për probleme teknike:</b> Ndërlidhjet dhe funksionimin e aparateve dhe pajisjeve teknike, përdorimin e veglave i kuptoj ...	me vështirësi	mesatarisht	shumë shpejt dhe shumë saktë		

<b>Kuptimin e formave:</b> Gjatë vizatimit, disenjimit, krijimit dhe punës së dorës gjërat më shkojnë...	rrallëherë	mund të përdoren	mirë dhe bukur		
<b>Aftësia e paramendimit të hapësirës:</b> Mund të paramendoj se duket, planet, skicat dhe vizatimet në realitet...	me vështirësi	mesatarisht	lehtë dhe pa mund		
<b>Planifikimi :</b> Kohën time gjatë detyrave, kohës së lirë apo punëve tjera mund ta organizoj...	shumë vështirë	mjaft mirë	shumë mirë dhe me kuptim		
<b>Të menduarit:</b> Pyetje teorike dhe çështje logjike i kuptojë...	pak me mund	kënaqshëm	shumë lehtë		



<b>Sjellja dhe aftësitë</b>	<b>Unë vlerësoj veten</b>	<b>Ti më vlerëson mua</b>
Aftësia për të qenë i rregullt		
Saktësia		
Besueshmëria		
Gatishmëria për të ndihmuar		
Paraqitja (paraqitje e sigurt, mënyrë e mirë e sjelljes)		
Aftësia për të punuar në ekip (unë mund të punoj mirë me të tjerët)		
Gatishmëria për të mësuar (me dëshirë mësoj diçka të re)		
Gatishmëria për kompromise (nuk duhet patjetër të kem gjithnjë të drejtë, mund të pranoj edhe mendimet e të tjerëve)		
Spontaniteti (shpesh veproj spontanisht dhe në mënyrë impulsive)		
Gatishmëria për të rrezikuar (nganjëherë edhe rrezikoj)		
Aftësia për të vendosur (zakonisht mund të vendos shpejt dhe sigurt)		
Pavarësia		
Aftësia për të arritur qëllimin (atë çka synoj, mundohem ta arrijë në mënyrë konsekuente)		
Shpejtësia e punës		
Aftësia e të pamurit		
Aftësia e të dëgjuarit		
Talent muzikal		
Vizatim		
Aftësia e kontaktit me të tjerët		
Siguria në veten (e di çka dua dhe çka mundem)		
Rutinë në llogaritjet themelore		
Talent gjuhësor		



Vlerësimi i vetëvlerësimit

Vetëvlerësimi

Interesat

Këto janë tri fushat e mia të preferuara:

1.....

2.....

3.....

Për këtë interesohem në veçanti:

-----

Këto janë tri lëndët e mia të preferuara:

1.....

2.....

3.....

Aftësitë :


1.....

2.....

3....., etj.

Përmbledhje e fletëve të punës :

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_





## PYETËSORË për njohjen e „Shkollave për arsim të mëtutjeshëm“

Shkolla:.....

Data:.....

Personi kontaktues:.....

Numri i nxënësve në shkollë:.....

Tipi/lloji i shkollës: .....

### 1. Profesionet pas shkollimit

Për cilat profile ofrohet shkollim në këtë shkollë?

A ka mundësi tjera profesionale, pas shkollimit?

### 2. Lëndë të rëndësishme mësimore

Cilat janë lëndët më të rëndësishme mësimore?

Si është ndarja në mes të lëndëve të përgjithshme dhe lëndëve profesionale?

Në cilat lëndë është mësimi praktik (p.sh. në punëtori në formë projektsh), dhe në cilat lëndë është mësimi teorik, pra në klasë?

Sa kohë zgjatë ky shkollim?

### 3. Kërkesat

Cilat janë kërkesat që parashtrihen karshi personalitetit, p.sh. dëshira për të mësuar, kënaqësia për të mësuar? Cilat janë interesimet që duhet pas?

Çfarë është e nevojshme për tu pranuar në këtë shkollë? A ka provim pranues? Çka testohet në këtë provim? Sa pikë nevojiten për pranim?

A është kërkesa e madhe për tu regjistruar në këtë shkollë apo jo?

### 4. Perspektiva

Cilat mundësi shkollimi ofrohen pas përfundimit të kësaj shkolle?

A inkuadrohen lehtë apo vështirë të diplomuarit e kësaj shkolle në treg të punës?

Për çfarë arsye?

## 5. Përparësitë dhe mangësitë

Çka vlerësojnë nxënësit apo të diplomuarit e kësaj shkolle si përparësi të kësaj shkolle?

Çka vlerësojnë nxënësit apo të diplomuarit e kësaj shkolle si mangësi të kësaj shkolle?

## 6. Mendim yt personal

Çka të ka pëlqyer ty?

Çka nuk të ka pëlqyer?

Çka do të të shkaktonte vështirësi?

Ky lloj shkolle do të më:

- interesonte shumë
- interesonte pjesërisht

## Rëndësia e prindërve gjatë vendimmarrjes time



Mendo se cilat qëndrime janë të qëlluara në rastin tënd dhe cilat jo!

Rrumbullakëso të saktën!

Prindërit e mi...	
... përzihen shumë në vendimin tim.	
... nuk interesohen aspak se në cilën shkollë dua të shkoj.	
... më ndihmojnë shumë të gjej shkollën e përshtatshme, por nuk i marrin vendimet.	
...mundohen të më bindin për disa vendime që mua nuk më interesojnë fare	
... ma lënë mua se për çfarë shkolle të vendosë.	
... më këshillojnë shumë, se si të gjej shkollën e përshtatshme, për të cilën gjë gëzohem shumë.	
... do duhej të merreshin më mirë me çështjet e tyre, se sa të më këshillojnë pa ndërprerë.	

**Si do duhej të “vepronin” prindërit e tu gjatë përzgjedhjes tënde të shkollës?**

Do të duhej

.....  
.....  
.....  
.....



**Çka dëshiron ti konkretisht nga prindërit e tu, kur bëhet fjalë për përzgjedhjen e shkollës/profesionit?**



.....  
.....  
.....  
.....



## Reflekto vendimin tënd!

Pas vendimit për shkollën, a ke një dëshirë konkrete për profesionin e preferuar?

Po Jo

Nëse po, cili është ai? .....

Ti ende nuk ke një dëshirë konkrete për profesionin, por ide se çka do të mund të bëje. Cilat janë ato ide?

.....  
.....

A ka dikush që ndikon në vendimmarrjen tënde për shkollën?

Po Jo

Nëse po, kush?.....

Si je përcaktuar për këtë shkollë? .....

.....

A ke pas rast të njoftohesh me këtë shkollë?

Po Jo

Nëse po, ku?.....

A do doje të shkoje në këtë shkollë edhe nëse do të të duhej të udhëtoje?

Po Jo

Përse e preferon pikërisht këtë shkollë? .....

.....

A ke një pasqyrë mbi kërkesat e shkollës?

Po Jo

Çka të intereson në këtë shkollim?.....

.....

Çka të pëlqen? Cilat janë mundësit e tua profesionale pas përfundimit të shkollës?

.....

.....

Ku je ende i pasigurt në vendimin tënd?.....

.....

.....